




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, propozon :

Që duke u bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane ,nenit 11 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 si dhe nenit 20 par. 1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____ 2022 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

**PËR VAZHDIMIN E ORGANIZIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJEN E
KËSHILLAVE DHE KRYETARËVE TË KËSHILLAVE LOKALE**

Neni 1

1.VAZHDOHET, organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale në territorin e Komunës së Lipjanit cili organizim ishte pezulluar me Vendim të Komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale të datës 12.03.2020, përshkak të shfaqjes së Pandemisë Covid- 19 ku me masat e vendosura nga Qeveria e Republikës së Kosovës në atë periudë ndalohej edhe mbajtja e tubimeve publike.

2.Organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale në territorin e Komunës së Lipjanit do të fillojë në fillim të muajit maj të vitit 2022 dhe planifikohet të përfundojë në përfundim të vitit 2022.

Neni 2

Komisioni i Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale do ti kryej të gjitha detyrat, përkritazi me organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokale në pajtim me dispozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin

dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019

Neni 3

Për mënyrën e sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare për organizimin e zgjedhjeve të cekura do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Arsyetim

Baza juridike për ta propozuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 11 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 ku përcaktohet që Kuvendi i Komunës të miratojë Vendimin për organizimin e zgjedhjeve dhe të përcaktojë periodën kohore të mbajtjes së tyre.

Zgjedhjet për Këshilla dhe Kryetarë të këshillave lokale janë të rregullta dhe mbahen pas skadimit të mandatit të Kryetarëve dhe Këshillave lokale aktuale mirëpo të cilat ishin pezulluar përkohësisht për shkak të situates së krijuar me Pandeminë Covid 19, ku ndalohej mbajtja e tubimeve publike.

Nga të cekurat, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 1-020/02-14272

Lipjan, më 16.03 . 2022

